



**Për: Mediat e shkruara dhe elektronike**

**Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun**

**Subjekti: Grupi Parlamentar i AKR-së, organizoj sot debat publik, për Projektligjin për Kulturë , Rini dhe Sport.**

---

*Prishtinë, 23 maj 2008*

## **Njoftim**

**Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re**, ka organizuar të premten një debat publik, lidhur me Projektligjin për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili ka kaluar shqyrtimin e parë në Kuvendin e Kosovës.

Shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, z. Ibrahim Makolli, tha se qëllimi i këtij debati është që të merren mendime, vlerësime dhe ide të reja për këtë ligj, i cili i duhet patjetër Kosovës për një funksionim më të mirë, të atyre dikastereve që i përcakton ligji. Ai shtoj se debati me personalitete të fushave të ndryshme, do të ndihmojë që Grupi Parlamentar i AKR-së, të mund të informohet drejt mbi nevojat për përmirësim të këtij projektligji dhe mbi këto kërkesa të kontribuoj në rishikimin e tij.

Esat Brajshori, deputet i AKR-së, shtoj se debati i organizuar nga AKR është bërë më qëllimin që deputetët e Kuvendit të Kosovës, të mos punojnë ndaras nga ata njerëz, që janë më të lidhur me artin, kulturën dhe rininë në Kosovë, duke vlerësuar se një debat i tillë ka qenë i domosdoshëm.

Kjo iniciativë e AKR-së, është përshëndetur nga pjesëmarrësit që vinin nga fushat të ndryshme, që kishin të bëjnë me Projektligjin për Kulturë, Rini dhe Sport. Pothuajse shumica e debatuesve, shprehën kritika të ashpra sa i përket përmbajtjes së këtij Projektligji.

Luan Mulliqi, Drejtor i Galerisë së Arteve, nuk ka dashur ta quaj as ligj, atë që Ministria e Kulturës e ka hartuar, dhe e ka paraqitur para Kuvendit të Kosovës. Për më tepër Mulliqi është habitur se si ky projektligj ka kaluar në leximin e parë, duke shprehur vërejtje të mëdha sa i përket përmbajtjes së ligjit, sidomos në aspektin e specifikimit të disa çështjeve të rëndësishme. Brajshori, duke arsyetuar votimin e këtij projektligji pas leximit të parë, tha se AKR-ja do ta korrigjoj dhe plotësoj këtë ligj me vërejtjet që bëhen edhe gjatë këtij debati. Ndryshe ai ka shtuar se, pa këto përmirësime, AKR nuk do ta votojë këtë projektligj.

**Zyra për informim e AKR-së**